



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 55 // 3 Prot.

Tiranë, më 22.05.2024

V E N D I M

Nr. 150, Datë 22.05.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 74, datë 09.04.2024, e z. V.Q kundër disa punonjësve të Komisarariatit të Policisë nr. 1 dhe nr. 2, Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “U zura me komshinjtë dhe qëlloi me sopatë dhe shqeu zinxhirin e portës dhe unë ndenja brenda në shtëpi. Policia më kapi kur punoja taksist, pasi jam invalid prej 27 vitesh me sëmundje. Shefat e Komisarariatit nr. 1 dhe nr. 2, ku kam denoncuar, ata të gjejnë menjëherë kur duan të mbyllin çështje, thonë s’ka adresë dhe ti s’ke firmosur vetë. Unë i thashë kam firmosur dhe kopjet i kam në shtëpi dhe e gjeta kopjen dhe mora në telefon shefin e Komisarariatit nr. 2, por nuk e hapi telefonin dhe kur i bëra mesazh, nuk u përgjigj”.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ankesa kishte mangësi të anës formale, që lidhen me identifikimin e qartë të subjekteve ndaj të cilëve drejtohet ankesa dhe lidhjen e shkakut të pretenduar me veprimet konkrete të subjekteve kundër të cilëve drejtohet ankesa.

- Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 557/1, datë 22.04.202, ka kërkuar nga subjekti ankues që të përcaktojë në mënyrë të detajuar, si më poshtë:

¹ Referuar librezës nr. 5068, datë 01.10.2023 të lëshuar nga Shoqata e invalidëve të Punës të Shqipërisë, ankuesi është invalid i plotë.

- Kush janë subjektet që pretendohet se kanë kryer diskriminimin tuaj, duke saktësuar veprimet e secilit prej tyre? Pra, duhet të saktësohet data, vendi dhe veprimet diskriminuese të kryera nga secili prej subjekteve.
- Shpjegime, fakte dhe prova të pasojave të ardhura nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr. 1 dhe nr. 2, Tiranë.
- Masat që kërkohet të merren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Çdo informacion tjetër, që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Ankuesi ka marrë dijeni për shkresën nr. 557/1, datë 22.04.2024, me datë 23.04.2024, fakt ky që rezulton i provuar nga lajmërim marrja e shërbimit postar: RR595926303AA, të administruar në dosje, por nuk ka kthyer përgjigje.

Subjekti ankues, me gjithë afatin kohor që kishte në dispozicion, nuk dërgoi asnjë dokumentacion lidhur me ankesën dhe nuk përmbushi kërkesat ligjore për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;....., Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga z. V.Q, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA